



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1193/Prot  
/1

Tiranë, më 03/12 /2015

**Lënda:** Jepet mendim mbi projektligjin "Për kontrollin kufitar".

**Drejtuar:** Z. Saimir TAHIRI  
MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME

Tiranë

I nderuar z.Tahiri,

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr. 8714 Prot, datë 24.11.2015, në projektligjin "Për kontrollin kufitar" sugjerojmë heqjen e pikës 3 të nenit 20 të tij.

Ky parashikim vlerësohet i panevojshëm, pasi administrimi i të dhënave në veprimtarinë e çdo kontrolluesi, duke përfshirë veprimet që do të kryhen sipas parashikimeve të kësaj dispozite por edhe në tërësi të këtij projektligji, është parashikuar dhe duhet realizuar në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar si dhe Vendimin nr.2, datë 10.03.2010 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "Për përcaktimin e procedurave të administrimit të rregjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre" i ndryshuar.

Me përshtatjen e kësaj dispozite, ky projektligj vlerësohet i hartuar konform kërkesave të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Besnik DERVISHI  
  
KOMISIONERI